



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.69/2019
Prishtinë, më 19.6.2019, në orën 15:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Glauk Konjufca, Memli Krasniqi dhe Muharrem Nitaj, anëtarë. I pranishëm: Sali Zyba, deputet.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Liburn Aliu, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

E ftuar: Ambasadorja Nataliya Apostolova, shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuese e Posaçme e BE-së në Kosovë.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu, Rasa AUTAKAITE-TUNAITIENE, Vadim Deleu, Miha Pezelj dhe Dinka Zivaj, Zyra e BE-së; Agron Demi, GAP; Argjend Zhubi, Ambasada e Britanisë; Njomëza Arifi, GLPS; Ardiana Tusha, KDI dhe Marigona Bajrami, GPPSD. Nga mediat: Taulant Osmani, BIRN; Nexhmie Hyseni, EO; Donika Osmani, RTV 21 dhe Lirdon Zeqiri, Klan Kosova.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, dhe praktikanti Afrim Berisha.

Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Diskutim lidhur me monopolin në fushën e homologimit të veturave/barriera jo-tarifore për importin e veturave të reja që kanë origjinën nga BE**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Diskutim lidhur me monopolin në fushën e homologimit të veturave/barriera jotarifore për importin e veturave të reja që kanë origjinën nga BE

Kryetarja– Ne e kemi një letër në “hard copy”, lidhur me shqetësimin e ngritur përmes përfaqësueses së BE-së, znj. Apostolova, për homologimin e veturave dhe janë pajtuar të gjithë anëtarët e komisionit që në të ftojme znj. Apostolova në komision, që të shpalosë komplet shqetësimet e saj, edhe pse ne si deputetë jemi të njohur me këto shqetësime. Natyrisht, që komisioni të cilin unë e udhëheqë, ka një gamë të gjerë të sferave, të cilat i mbulon dhe i mbikëqyrë. Pra, ka katër ministri, tetë agjenci të pavarura dhe mbi 25 fusha të caktuara që duhet t’i mbikëqyrë dhe t’i analizojë e t’i shoh ngecjet, me të cilat përballen ato. Kolegët, sigurisht që e kanë parë në Raportin e Progresit për vitin 2019, të evidentuar çështjen e homologimit të detyrueshëm të veturave nga jashtë. Sot, ne do të kemi rastin që të dëgjojmë edhe nga znj. Apostolova, gjithë historikun e komunikimit me institucionet e Kosovës. Natyrisht, që edhe deputetët, sigurisht do të kenë diçka për të shtuar. Fjalën ia jap ambasadores Apostolova.

Ambasador Nataliya Apostolova, shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuese e Posaçme e BE-së në Kosovë – Jam shumë e lumtur që jam sot këtu me ju, që të diskutojmë për çështjet që janë shqetësim i përbashkët i yni. Të nderuar anëtarë të këtij komisioni, siç edhe e dini, konkurrenca është njëri nga elementët më esencialë në funksionimin e tregut të lirë dhe njëkohësisht është një fushë e cila në Kosovë duhet ta përmirësojë veten, është një temë e cila bie të mira për njerëzit, si konsumatorë, duke e inkurajuar krijimin e qëllimeve dhe dëshirave për të zgjedhur. Kjo rezulton edhe për t’u mundësuar konsumatorëve, për të blerë dhe që gjërat t’i kenë me çmimet më të mira të mundshme. Nuk e di se kur ju si komision e keni shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë së Konkurrencës. Monopoli për homologimin e veturave, është bërë çështje e diskutimit. Së pari, më lejoni të theksojë se Kosova duhet të vërë në vend së paku kornizën legjislative, e cila merret me konkurrencën, ndërsa institucioni i konkurrencës së Kosovës është institucioni kyç për t’i luftuar monopolet, mirëpo si duket ka ndodhur një keqkuptim dhe një mungesë implementimi të vendimeve të konkurrencës së legjislacionit ekzistues në fuqi. Zyra e BE-se është e involvuar me vite dhe disa nga ju e keni diskutuar edhe me mua, kur kam qenë në takime me Qeverinë, kemi ngritur brengat tona me Ministrinë e Infrastrukturës, Kryeministrin dhe Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës. Do të kisha dashur të shkoj më në detaje, lidhur me çështjen. Ne kemi dy çështje këtu, e para monopoli në homologimin e veturave dhe e dyta importimi i veturave nga BE, e cila është një barrierë serioze për tregtinë. Sa i përket monopolit për homologimin e veturave, aktualisht jemi të brengosur se ka një udhëzim administrativ i vitit 2018, i cili ka çuar në zgjerimin e monopolit të tanishëm, ndonëse kontratave iu del afati në korrik 2019. Pra, siç na pati thënë atëherë ministria në fjalë, ne kemi frikë se kjo kontratë prapë do të vazhdohet në mënyrë automatike dhe setapi (Set up) i tanishëm do të bëjë restriksione në monopolin e homologimit me këtë zgjatje automatike të operatorit ekonomik “Euro Lab” i cili e ka marrëveshjen ekskluzive që nga viti 2008. Konkurrenca në mes të shërbimeve gjatë homologimit do ta ngriste çmimin dhe nuk do të japë shërbimet më të mira. Tanimë, qytetarët e Kosovës po paguajnë çmim më të lartë për shërbimet të cilat u ofrohen vetëm në Prishtinë, kështu që duhet të gjithë të udhëtojnë në kryeqendër, që nuk janë të sfiduara nga asnjë kompani tjetër dhe natyrisht këto çmime janë më të larta se në vendet tjera. Pastaj, homologimi i veturave është një barrierë serioze e tregtisë për veturat e reja. Sa i përket barrierave jotarifore, BE-ja dhe shtetet anëtare kanë një brengë, sa i përket homologimit mandator dhe verifikimit të certifikatave të konformitetit të veturave të reja

me origjinë nga BE-ja. Kjo është kundër rregullave të konkurrencës së BE-së dhe është kundër MSA-së. Pavarësisht pajisjes me certifikatën e konformitetit nga prodhuesit e BE-së, të gjitha veturat e reja në Kosovë janë të obliguara të shkojnë nëpër procesin e homologimit edhe një herë. Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës ka dhënë një rekomandim se ky sistem është kundër tregtisë dhe konkurrencës së fer, dhe i ka thënë ministrisë që të kenë në konsideratë opinionin profesional për homologimin e veturave, që e ka lëshuar autoriteti në fjalë. Muajin e kaluar zyra e BE-së, e ka mirëpritur në mision TAIEX-in për homologimin e veturave. Dy ekspertët, të cilët janë nga Lituania, kanë pasur një takim me përfaqësuesit e asociacionit të veturave dhe ekspertët e kanë lehtësuar sistemin e homologimit të deritanishëm dhe kanë dhënë lehtësim, lidhur me kornizën e tanishme ligjore dhe kanë dalë me të gjetura zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës. Ne, fuqimisht kemi inkurajuar ministrinë që ta revidojë udhëzimin administrativ në linjë me rekomandimet në fjalë, për t'i adresuar kritikën në homologimin e veturave. Tani, në janar të këtij viti, ne kemi lansuar projektin prej 3 milionë eurove të asistencës teknike për konkurrencën shtetërore, por kur nuk ka vullnet politik dhe pa një lidhësi të fuqishëm këto ndryshime nuk do të ndodhin. Të nderuar anëtarë të komisionit, po e ngre këtë çështje me ju, sepse ju si Kuvend, duke pasur në mbikëqyrje në funksionimin e Qeverisë dhe ju përfaqësoni njerëzit e Kosovës dhe duhet jeni të sigurt që konsumatorët, aktualisht, janë qytetarë të Kosovës dhe duhet të blejnë të mira cilësore dhe të marrin shërbimet më të mira me çmim më të mirë. Komisioni juaj duhet t'i bëjnë këto rekomandime Kuvendit të Kosovës, t'i mbajë në mendje se homologimi i veturave është në kundërshtim të MSA-së dhe më lejoni edhe një herë këtu të nënvizoj se është jo i dobishëm për konsumatorët e Kosovës. Më lejoni të përfundoj, duke thënë se rëndësia e këtyre ndryshimeve në fushat kyçe të fushës së tregtisë dhe tregut është pikë kyçe për të pasur sukses implementimi i MSA-së, por ajo që është më e rëndësishme nga këto ligje, më së shumti përfitojnë njerëzit e Kosovës. Unë dhe dy ekspertët e mi, jemi shumë të gatshëm t'iu përgjigjemi pyetjeve tuaja në këtë çështje, që është shumë sensitive.

Kryetarja– Pajtohem plotësisht me atë që tha ambasadorja, paraprakisht, sidomos për njohjen e certifikatës së konformitetit të BE-së, me rastin e hyrjes së veturave të reja në Kosovë, sepse kështu siç është, është barrë e shumëfishtë për qytetarët e Kosovës dhe kjo gjë mendoj që është e paarsyeshme.

Glauk Konjufca –Kjo ka qenë në Kosovë njëra prej temave dhe në njëfarë mënyre pajtohem të gjithë, që kjo përbën një lloj të praktikave të monopolit mbi një fushë të caktuar dhe që është plotësisht kundër frymës, rregullave dhe ligjeve të BE-së dhe të marrëveshjes së MSA-së. Duket që askush nuk ka dyshim që kjo gjë që ka ndodhur ka qenë në shpërputhje me ligjin, nuk është kjo që në njëfarë mënyre ka ndodhur me homologimin e veturave. Është një farë procesi ku ka mjegull dhe ku dikush e ka shfrytëzuar që të marr një vendim të keq dhe i cili është në shpërputhje me standardet evropiane dhe të ekonomisë së lirë të tregut sepse në përputhje edhe me ligjet që i kemi në fuqi ndoshta ato ka nevojë që të jenë edhe më të forta, mirëpo bazamenti i tyre është i mjaftueshëm për t'i luftuar monopolet, pra ne kemi bazament ligjor nëse duam t'i luftojmë monopolet dhe po të kishte vullnet politik kjo do të ndodhte. Por vetë fakti që Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës e ka shpallur këtë vendim në shpërputhje me ligjet tona, është e mjaftueshme që Qeveria e Kosovës të alarmohet dhe me vendosë në përputhje me atë agjenci dhe me atë autoritet, i cili është kompetent që të vlerësojë nëse është në shpërputhje me ligjet e konkurrencës dhe me principin e konkurrencës së lirë, e cila është baza e një ekonomie të tregut. Mendoj që është vonë znj. Apostolova për këtë proces, kur them vonë, nuk them që

procesi është i pakthyeshëm. Unë mendoj që ka përgjegjësi përtej asaj që ne duhet ta marrim një vendim të drejtë. Këtu ka përgjegjësi penale dhe dikush duhet të dënohet, sepse unë mendoj që ka pasur përfitim të paligjshëm dhe përfitimi është dhjetëra miliona euro, që mos të them qindra miliona euro. Kështu që nuk është e thjeshtë, që ne do ta shkëpusim këtë praktikë të paligjshme në një moment të caktuar, por duhet t'i shkojmë kësaj deri në llogaridhënie, sepse prej këtyre monopoleve, prej kësaj praktike të padrejtë kanë përfituar disa njerëz. E tëra që na mbetet neve si Kuvend është që të zbulojmë që a ka pasur aty prapavijë politike dhe lidhje politike mes atyre njerëzve që kanë përfituar dhjetëra miliona euro dhe njerëzve me kompetencë vendimmarrëse, të cilët nuk i kanë marrë vendimet e duhura.

Hykmete Bajrami– Prezenca e ambasadores Apostollova këtu dhe ankesa për një çështje të cilën e ka ngritur edhe opozita edhe shoqëria civile, dhe siç e tha kolegu parafolës, jo vetëm si rezultat i udhëzimit administrativ që do e vazhdoj monopolin, por jemi ankuar me vite të tëra sa ka qenë ky monopol në fuqi, tregon më së miri për nivelin e qeverisjes që e kemi sot dhe për llojin e qeverisjes që e kemi sot. Nëse ambasadorja znj. Apostollova po u tregon Kuvendarëve që nuk jeni duke e mbikëqyrur Qeverinë, kjo tregon nivelin e punës që ne po e bëjmë, por edhe që në fakt rekomandimet e Kuvendit nuk po i merr parasysh aspak Qeveria. Në emër të grupit Kuvendar, këtë çështje e kam ngritur në muajin korrik të vitit të kaluar. Kemi pasur nga Instituti GAP një analizë të hollësishme, e cila iu është dërguar të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe kemi kërkuar, ashtu siç kemi konstatuar së bashku me të gjithë të tjerët, që në mënyrë automatike të shfuqizohet udhëzimi administrativ, sepse është joligjor, duke qenë joligjor është jokushtetues, sepse ai udhëzim administrativ është komplet në kundërshtim me nenet e ligjit për automjetet, ligj të cilin e ka bërë Qeveria paraprake dhe një prej synimeve të Qeverisë ka qenë që të eliminohen monopolet. Mua më kujtohet që ne kemi pasur edhe një vendim për anulimin e monopoleve në Qeveri dhe pas diskutimeve ju që i keni pasur me ministrinë e infrastrukturës dhe të tjera është ardhur në përfundim që shkëputja e një kontrate në mënyrë të njëanshme mund të qoj në dëme të cilat më vonë do të duhej të kompensoheshin, mirëpo, pas përfundimit të asaj kontrate, me u vazhduar me një udhëzim administrativ çfarë sot e kemi në fuqi, është tepër fatkeqe. Ne kemi ushtruar rolin tonë deri aty ku e kemi parë të arsyeshme dhe brenda kapaciteteve tona si opozitë, por besoj që ka ardhur koha që t'i bashkojmë forcat dhe të jemi më të zëshëm në këtë rast kundër keqpërdoruesve që po e dimë të gjithë se cilët janë, sepse në fakt ata kanë nënshkrime dhe kanë emra, para se me qenë barrierë jotarifore dhe gjithçka tjetër, ne si përfaqësues të popullit duhet ta kemi parasysh interesin e qytetarëve tanë dhe në të vërtetë që nga viti 2008 ne i kemi penalizuar qytetarët tanë dhe ato para kanë shkuar në xhepat e grupeve të ndryshme të interesit dhe ne dyshojmë që ato janë nda natyrisht me ata të cilët i kanë mbështetur dhe i kanë krijuar këto monopole. Ne dimë me qenë kritikues gjatë gjithë kohës që po përmbushim kriteret por ja që ka kriteret, të cilat nuk po i përmbushim dhe ka premtime që nuk po i përmbajmë dhe besoj që edhe bashkësia ndërkombëtare duhet të fillojë zëshëm të bëjë dallimin në mes të atyre të cilëve përkrahin politikën dhe njohin mbështetjen e juaj dhe atyre të cilëve nuk po i marrin parasysh këto gjëra, kështu që ne jemi këtu, kemi me qenë të zëshëm edhe më tutje por po kërkojmë fuqishëm prej organeve të drejtësisë që të merren me udhëzimin administrativ, sepse është joligjor dhe gjithashtu shqetësimet e juaja janë edhe shqetësime tona.

Muharrem Nitaj –Realisht, për shqetësimin që u ngrit, në këtë takim, nuk është se kemi dallime ne qasje, por duhet të shikojmë çfarë duhet të bëjë komisioni që ta shtyjë këtë çështje përpara. Kolegia Bajrami po thotë që opozita e ka ngritur këtë shqetësim. Realisht, homologimi

është një gjë e trashëguar tash e sa kohë dhe ka qenë problem po kaq i madh edhe në kohën kur znj. Bajrami ka qenë anëtare e kabinetit qeveritar. Nuk dua që ta qes në planin politik, por dua që eventualisht të shohim se cilat janë mundësitë që të gjejmë një zgjidhje, edhe të vrasim monopolin, edhe t'i heqim masat të cilat janë krejt të palogjikshme, siç është certifikata për veturat e reja që vijnë dhe i nënshtrohen procesit të homologimit, prandaj edhe ju nëse keni ndonjë ide sesi do të mund të na ndihmoni.

Salih Zyba– Ky problem është edhe serioz edhe i kamotshëm. Nga një vizitë që kemi pasur lidhur homologim, unë po shkëpus diçka konkrete. Aty kam pyetur rreth udhëzimit, i cili është problemi kyç edhe i atyre shqetësimeve që i ngritët ju në këtë rast edhe si monopol edhe si barriera jotarifore. Pyetjet që i kam bërë për udhëzimin drejtuar menaxherit ka qenë rreth hapësirës, menaxhimit, kapaciteteve njerëzore dhe teknike që i posedon homologimi dhe në secilën pyetje më është përgjigjur me “Po, po, po, unë i plotësoj këto kapacitete”. Këto kapacitete janë në përputhje me këtë udhëzim, sepse udhëzimi është nxjerrë për këto kapacitete, d.m.th. udhëzimi iu është përshtatur kapaciteteve që i ka në dispozicion i njëjti pronar në kohë shumë të gjatë që i ka pasur, problemi është udhëzimi. Shkëputa diçka nga fjala juaj hyrëse, kur thatë që kemi kërkuar ta revidojnë udhëzimin administrativ, nëse kërkesa juaj nuk ka hasur aty ku duhet, unë propozoj që ky komision ta marrë në raportim, fillimisht drejtuesin e dikasterit përkatës të kësaj ministrie, që mbulon këto përgjegjësi, e në rastin tjetër, i ka dhënë edhe mbështetje, dhe nëse jo, të ketë një interpelancë në Kuvend, në të cilën pashmangshëm duhet të raportojë aty ku është e ndryshueshme dhe e përmirësueshme është më se e nevojshme. Ndërsa, për kolegët që ngritën shqetësime për vepra penale edhe ato duhet të procedohen, sepse kur konstatohen shkelje është përgjegjësi edhe e deputetëve por në veçanti edhe e këtij komisioni që të iniciojë procedura penale, përkundër kufizimeve që i ka si mandat. Dua të ngre edhe një shqetësim që është konkret është bërë një praktikë në Doganë, që secili automjet nga vendet e BE-së së pari i kryen disa obligime për homologimin pastaj bëhen pagesat e Doganës e që do duhej të ishte e kundërta ose që mos të ekzistoj kjo barrierë.

Memli Krasniqi, tha që fillimisht i vije keq që këtë takim po e mbajmë me iniciativën e znj. Apostolova dhe është një tregim i keq për traditën politike të Kosovës që duhet të vijë një ambasador të na mbledhë për të diskutuar tema të cilat kemi mundur të diskutojmë edhe vet. Në fakt në këtë komision ne kemi pas kërkuar që ta thërrasim në raportim edhe ministrin e infrastrukturës, por prapë mirë se keni ardhur znj. Apostolova dhe faleminderit për iniciativën edhe pse kjo temë realisht siç e pamë nga diskutimi i kolegëve të mi, nuk është duke u trajtuar dhe nuk do të trajtohet asnjëherë si temë ekonomike, as si çështje që ndërlihet me konkurrencën as me monopolin, por vetëm do të trajtohet si çështje politik. Qëndrimi im sa i përket monopoleve bindjet e mia politike, ekonomike dhe ideologjike janë kundër monopoleve dhe mendoj që vetëm konkurrenca, mundësitë e barabarta dhe tregu i lirë mundësojnë zhvillimin e një vendi. Dua të jap një perspektivë tjetër sepse po e shoh një konformizëm të frikshëm tek ky komision, është një konformizëm ku të gjitha diskutimet po dalin “mirë e ki ambasadore, duhet të bëjmë diçka për këtë punë”, ju po flisni për standardet e BE-së dhe ne standardet e BE-së i kemi bërë obligim prej Kushtetutës sonë dhe në gjithë legjislacionin, pyetja ime e parë është se a është homologimi i veturave dhe vendosja e tyre në trafik standard i BE-së, dhe a bazohet në Direktivën 2007/46 të Komisionit European? Çka thotë kjo direktivë sa i përket homologimit, a e ka bërë obligim homologimin e veturave për shtetet e BE-së? Të gjithë ju përpos Blertës, jeni nga shtetet e BE-së, a ka homologim të veturave në vendet ku jetoni dhe

nëse ka homologim ,kush është përgjegjës për këtë çështje, cila ministri apo agjenci, a janë ata që e bëjnë homologimin si organe të shtetit apo janë organizata tjera të cilat e bëjnë homologimin? Më intereson ta dijë a ka shtete anëtare të BE-së ku ka monopol në homologim? Sa i përket certifikatës së konformitetit, unë mendoj që as që duhet të diskutojmë sepse certifikatën e konformitetit nga BE-ja duhet ta kemi të pranuar sepse kemi nënshkruar marrëveshjen e MSA-së dhe ka qenë një përparësi për veturat sidomos për ato të reja që ka mundësuar një importim më të lirë sesa në të kaluarën. Kam menduar që për veturat e reja nga BE-ja, duhet të bëhet vetëm një homologim i tipit, pra jo të homologohet çdo veturë sepse është absurde, por vetëm tipi i saj i cili i plotëson kushtet sipas ligjit, pra është e rëndësishme që standardet të cilat ju po i përmendeni të jenë të implementueshme në Kosovë, po e them këtë znj. Apostolova duke kërkuar mirëkuptimin tuaj sepse ne kemi miratuar ligje me rekomandime të BE-së e që nuk janë standarde të BE-së, kemi këtu tre ish- ministra duke më përfshirë edhe mua, dhe për shkak të rekomandimeve të paraardhësve tuaj të zyrës së BE-së e kemi miratuar ligjin e prokurimit publik ku i kemi obliguar ministrat të nënshkruajnë të gjithë tenderët dhe kontratat për të cilat ata asgjë nuk dine. Asnjë vend i BE-së nuk e ka këtë standard, mirëpo ju na keni thënë që është standard i BE-së, tri herë ka kaluar në lexim të tretë në Kuvend sepse na kanë thënë që do të merrni Raportin e Progresit negativ. Kemi pasë diskutim edhe për veturat pikërisht në këtë komision, ku kemi diskutuar për importimin e veturave të vjetra deri në 15 vjet, keni reaguar Ju, madje ashpër keni reaguar, prandaj unë i'u pata pyetur edhe publikisht, sipas cilit standard dhe rregullator, sepse asnjë shtet i BE-së nuk e ndalon importin e veturave sipas moshës së tyre, por ju na keni thënë që është standard i BE-së, prandaj standardet duhet të jenë uniforme për të gjithë. Ne jemi 100% të përkushtuar në standardet e BE-së por nuk mund të kemi pranueshmëri për qasje e cila mund të rrezikoj që të jetë qasje me standarde të dyfishta. Dhe a janë krejt shtetet anëtare të cilat ju i përfaqësoni të mendimit të njëjtë me juve? Sepse ne po dëgjojmë që ka shtete që janë 100% me këtë që ju thuani, por ka edhe shtete tjera që mendojnë më ndryshe, sepse nganjëherë ne po hyjme në ”gërshërë” të shteteve anëtare të BE-së për shkak të lobit të tyre.

Hykmete Bajrami –Sa i përket konformizmit këtu shihet qartë që janë dy blloqe, ata që janë kundër monopolit të homologimit dhe ata që e mbështesin monopolin e homologimit. Që është politiziu, normalisht që politizohet sepse je duke e diskutuar në një komision ku i ke të përfaqësuar 5-6 parti politike, sepse ka qenë partia juaj dhe me nënshkrim të ministrit tuaj që në vitin 2008 ia ka dhënë monopolin në homologim të veturave për 10 vite, pastaj ka qenë partia ime që ka marrë një vendim që të eliminohen monopolet, pastaj kanë ardhur ekspertët dhe kanë thënë që ka një kontratë valide dhe nëse e shkëputni në mënyrë të njëanshme ka me shkuar në arbitrazh dhe do të i humbeni të njëjtat para dhe është partia e z. Nitaj i cili u shpreh se është kundër monopolit, por është partia e tij e cila po ujit monopolin. Nëse e dëgjuat znj. Apostolova e pat fjalën për Udhëzimin Administrativ 02/2018, ky udhëzim është nënshkruar më 12 prill të vitit 2018 dhe ka hyrë në fuqi më 19 prill të vitit 2018 tani këtu ose jemi pro ose kundër. Ajo çka ne jemi duke kërkuar është që të njihen certifikatat e konformitetit për veturat e reja, të hapet konkurrenca dhe mos të ketë kompani monopol për homologim për veturat e përdorura. Prandaj është mirë që të bëhemi bashkë që të rrëzojmë monopolin.

Memli Krasniqi, replikoi me znj. Bajrami duke nënvizuar se edhe në kohën sa ajo ka qenë në pushtet dhe ka qenë ministre nuk ka bërë asgjë për ta ndaluar monopolin, sepse kur është bërë vendimi për homologim në kemi qenë se bashku në qeverisje me 2008. Këtu ska qëndrim pro

monopoleve, pra mund të thuash që ke gabuar, apo kryetari i partisë suaj ka gabuar. Nuk mund të akuzosh z.Nitaj dhe partinë e tij, qeveritë nuk funksionojnë si të ndara, as nuk e keni ndaluar monopolin ju, as partia juaj as partia ime, për këtë arsye po thëm që mos të shndërrojmë diskutimin në një nivel shumë patetik, sepse për tre vite keni qenë pjesë e qeverisë dhe skeni folur asnjëherë për monopol dhe sot ju ka rënë ndërmend të flisni.

Dardan Sejdiu, tha se kjo është një temë të cilën e kemi përmendur në çdo vjet e në çdo kohë si çështje që duhet të shpërfaqet, ne në Kushtetutë e kemi të definuar llojin e ekonomisë që duhet ta ketë vendi, i themi ekonomi e tregut por e kemi trajtuar në forma dhe mënyra të ndryshme dhe pastaj po vijmë në situata si këto që kemi ardhur tani, qoftë për homologim, qoftë për monopolët tjera të cilat i kemi privatizuar, monopole natyrore etj. Është shumë me rëndësi për neve si komision që të dëgjojmë vërejtjet dhe sugjerimet tuaja si BE, dhe secili prej nesh kemi mendime e bindje për këtë çështje, kemi bindje politike sepse në fund të ditës ekonomia është politike. Për mua me rëndësi është si të trajtohet çështje dhe jo të dëgjoj polemikat në mes të dy kolegëve të mi, të cilët kanë pasur kohë të mjaftueshme që së bashku me i trajtuar këto tema në qeveri, për 14 vite sa kanë qeverisur së bashku. Si komision me ministrin por edhe në formate të ndryshme në Kuvend, kemi edhe kapacitete edhe mjete të ndryshme dhe vullnet për me e trajtuar këtë çështje dhe duhet ta zgjidhim.

Lutfi Zharku, më duket që jemi duke i bërë dy gabime esenciale, e para në të kaluarën si ka qenë situata dhe sot si është situata. Ne të kaluarën ashtu si e ceku edhe kolegja ime znj Bajrami, e kemi gjetur një vendim i cili është nënshkruar në vitin 2008 dhe i cili ka garantuar monopol për 10 vite një kompanie të caktuar për homologim, të gjitha vërejtjet kanë shkuar në një drejtim që çdo vendim i qeverisë për shkëputje të njëanshme të kontratës do ta dërgonte qeverinë në arbitrazh apo në ndonjë gjykatë tjetër dhe qeveria do ta humbte rastin, kështu që nuk kishte zgjidhje tjetër përpos të respektohej vendimi apo marrëveshja e nënshkruar në vitin 2008. Gjatë qeverisjes sonë kemi ndryshuar ligjin për automjete, ligj ky i cili garanton liberalizimin e tregut në fushën e homologimit dhe garanton atë që znj. Apostolova tha që Kosova ka për obligim që t'i pranoj certifikatat e konformitetit, që do të thotë se çdo automjet i ri i cili homologohet sot, është në kundërshtim me ligjin e ri dhe është në kundërshtim me MSA-në. Sot, fatkeqësisht me Udhëzimin Administrativ 02/2018, ministri Lekaj nuk është duke e respektuar ligjin apo e ka përpiluar një Udhëzim Administrativ i cili është në kundërshtim me ligjin dhe me konkurrencën e lirë të tregut. Këto ishin sa për sqarim, ndërsa ne si komision jemi të hapur të bashkëpunojmë në mënyrë që të arrijmë të zgjidhim këtë problem.

Nataliya Apostolova, Shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuese e Posaçme e BE-së në Kosovë – Dëgjova me vëmendje diskutimin dhe disa nga deklaratat kanë qenë shumë konstruktive dhe disa nga deklaratat tjera kanë kërcyer nga tema në temë dhe kjo nuk është forma që unë duhet të përgjigjem për shefat e mëparshëm të BE-së, se për çfarë politikash ata kanë pasur dhe i kanë implementuar në Kosovë, sepse ju e dini që përfaqësimi në Kosovë i BE-së nuk është i personalizuar. Më keni ftuar me ekipin tim këtu që t'i ndaj detajet për çështjen e cila për neve është e një rëndësie të madhe, më lejoni të ju them që kjo është kështu sepse është e përcaktuar nga Direktivat evropiane të cilat mbrojnë konkurrencën në treg dhe kjo është për njerëzit e Kosovës, sepse ata përfitojnë shërbimet dhe të mirat që ofrohen në treg dhe me çmime më të mira për qytetarët e Kosovës, pra konkurrenca është baza e zhvillimit dhe nëse nuk do të ketë konkurrencë atëherë nuk do të ketë as zhvillim. Ministrin Lekaj dhe i kemi shprehur

bregën tonë për atë që po ndodh dhe këtu krejtësisht nuk pajtohem që ka interesa ekonomike të anëtarëve të BE-së të cilat e bëjnë jokonsistente politikën e BE-së, fakti që kam qenë me dy përfaqësuesit e dy shteteve më të fuqishme të Evropës që kanë interesim të madh për tregun e Kosovës, pra Gjermani dhe Franca, është dëshmi e fuqishme që ne së bashku jemi në këtë proces, dhe nëse ne vazhdojmë me këtë lojë e fajësimit ne i shmangemi qëllimit të këtij takimi, pra momenti ka ardhur në korrik të vitit 2019 kur ky udhëzim i famshëm administrativ, falë zotit do të përfundoj atëherë. Unë kam qenë të kryeministri, kam qenë të ministri i infrastrukturës kam biseduar me të gjitha autoritetet të cilave zyra ime duhet të iu adresohet dhe deri më sot nuk kam pasur asnjë reagim nga ana e tyre, kam ardhur të bisedoj me ju sepse ju e keni fuqinë ju e përfaqësoni popullin e Kosovës, ju jeni ata që e mbikëqyrni punën e kësaj qeverie, prandaj ngrisi zërin, dhe na përkrahni e na ndihmoni ne sepse këtë edhe e dëshirojmë dhe tani është momenti sepse nëse ik korriku i vitit 2019 ju do t'i keni edhe 10 vite trajtim të njëjtë dhe besoj që njerëzit e Kosovës nuk e meritojnë këtë. Ne kemi angazhuar ekspert dhe kemi raportin e TAIEX-it, më duhet të them që nuk ka qenë e lehtë që ta bëjmë këtë sepse nuk ka pasur shumë energji brenda ministrisë që të pranoj këta ekspertë sepse gjërat të cilat qartë i thotë që raporti janë që duhet të ndërrohen rregullativat, për të cilat mund të na flas eksperti i cili është këtu me mua dhe mund të na shpjegoj, pra ne i kemi bërë të gjitha për t'i ndihmuar Kosovës në mënyrë që të zgjedhë këtë çështje rreth konkurrencës, kemi filluar në shkurt me një projekt shumë të fuqishëm dhe ju thatë që nuk keni kapacitete për atë arsye ne dëshirojmë t'i trajnojmë njerëzit dhe t'i involvojmë të gjithë që do të merren me këtë çështje dhe të merren seriozisht. Mos e përdoreni këtë një lloj loje se kush është fajtori apo kush e ka bërë këtë apo atë para 10 vitesh, momenti ka ardhur që të gjithë ju të bëheni së bashku dhe të na ndihmoni ne që të bëjmë presion qeverisë që të marrë përgjegjësinë për këtë çështje. Është mirë që kjo që po diskutojmë po xhirohet dhe po shfaqet te njerëzit e Kosovës sepse ne jemi duke diskutuar për ta dhe jam e gatshme ti diskutojmë të gjitha detajet dhe kjo është ne duart tuaja pra varet nga ju.

Vadim Deleu, eksperti i BE-së– Mua më është dhënë kjo detyrë dhe unë jam ai që i ka përcjellë ekspertët e respektuar të cilët e kanë komunikuar raportin me të gjeturat në institucionet gjegjëse në Kosovë dhe ata kanë dalë me disa të gjetura dhe ju mund ta merrni një kopje të këtij raporti. Këta ekspert duhet të vijë prapë, apo ekspertë të tjerë sepse ekziston edhe misioni i dyte i cili do të ndodhë brenda TAIEX-it, i cili do të konsolidoj këto të gjetura të cilat natyrisht jemi të lumtur t'i ndajmë me ju. Kjo çështje është komplekse dhe për këtë arsye ne kemi angazhuar ekspertët, për shembull çështja që ju ngritët tek pranimi i tipit të veturave në mënyrë që kjo të vlejë për të gjitha veturat dhe të pranohet certifikata e konformitetit është një gjë që bëhet në shtetet e BE-së, një çështje tjetër që ju e përmendet është homologimi i cili ndodhë edhe në shtetet e BE-së dhe këto shtete kanë modele të ndryshme të homologimit të veturave dhe këto së pari duhet të kalojnë në kontroll teknik mandator, janë edhe disa rekomandime që janë dhënë sa i përket ligjit primar dhe sekondar që janë dhënë nga këta dy ekspertë e që duhet analizuar me kujdes.

Memli Krasniqi– Në fakt unë pyetjet i kisha shumë konkrete, por nuk mora përgjigje, prandaj pyetjen tani do ta bëjë në anglisht, pyetja ime ishte: a është homologimi mandator për shtetet anëtare të BE-së a ka ndonjë direktivë për këtë? A keni homologim për të gjitha shtetet e BE-së ose jo? Dhe nëse po, kush është ai organ i cili është përgjegjës për këtë? A ka ndonjë shtet të BE-së që ka ndonjë lloj të monopolit në homologim?

Vadim Deleu, eksperti i BE-së– Do të mundohem të jap përgjigje në këto pyetje. Së pari, do t'i referohem raportit dhe të gjeturave në raport nga ekspertët e TAIEX-it. Ekziston nevoja për homologim, sepse kemi tregje të ndryshme dhe prodhues të ndryshëm dhe kjo është një gjë që nuk mund ta ndalojmë për importin e veturave nga Japonia, Kina apo tregje të tjera. Tregu i BE-së operon më ndryshe dhe ekziston homologimi dhe nuk është mandator për të gjitha veturat këto janë përgjigjet për dy pyetjet tuaja. Ndërsa, ekspertët nuk e kanë analizuar apo shikuar homologimin që ka të bëjë me shtetet e BE-së, për secilën, por kanë ardhur ta bëjnë këtë analizë për Kosovën dhe mendoj që direktiva nuk do të duhej të ishte përshkruese për atë që ju bëtë si pyetje, por unë mendoj që ka konkurrencë në shtetet e BE-së dhe është Drejtoria e Përgjithshme Konkurrencës në BE, e cila thotë fjalën e fundit për konkurrencën.

Nataliya Apostolova, shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuese e Posaçme e BE-së në Kosovë –Z. Memli, ju pyetët që a ka ndonjë shtet të BE-së që e ka aranzhuar në mënyrë të ndryshme. Ndoshta po, por nëse ka ndonjë shtet anëtar, i tillë, atëherë është kompania shtetërore ajo që e bënë këtë, por jo kompani private, dhe e dyta, mos harro të lutem, se në BE kemi Drejtorinë e Përgjithshme të Konkurrencës, e cila mundohet gjithmonë që të menaxhojë çdo nivel, brenda shteteve anëtare që merret me lirinë e tregtisë dhe konkurrencë së transportit dhe të gjitha këto kompani që e anashkalojnë këtë, sillen para Gjykatës Evropiane dhe e dini që ka shumë vendime të Gjykatës Evropiane, të cilat kanë dënuar kompanitë, dhe në këtë sens, unë kultivoj këtë që të gjitha ato shtete që thyejnë këto ligje duhet të paguajnë këto të holla. Prandaj, të gjitha këshillat e ekspertëve që më jepen mua, kujdesemi që të jenë në përputhje me standardet e BE-së dhe jo në përputhje me një standard të një shteti, sepse në fund të ditës, ne i respektojmë rregullat e konkurrencës. Nuk kemi shumë kohë, korriku po vjen dhe duhet ta gjejmë mënyrën për të bërë presion që ky udhëzimi administrativ të amandamentohet automatikisht, sepse nëse nuk amandamentohet automatikisht, vazhdohet kontrata për 10 vite. Mënyra më e lehtë do të ishte që z. Pal Lekaj ta anulojë Udhëzimin Administrativ ose Kryeministri.

Hykmete Bajrami – Do të ishte mirë që ne këtu të vendosim se cili do të jetë hapi i radhës që do ta marrim si komision në mënyrë që ky debat mos të mbetet vetëm si transmetim, t'i lëmë debatet personale, por të vendosim për hapin konkret, ta ftojme ministrin në raportim, kontrata e homologimit që e ka kompania e caktuar me ministrinë e infrastrukturës do të vazhdohet automatikisht nëse nuk ndërpritet. Kërkojë që të mbahet një seancë, interpelancë me ministrin e Infrastrukturës dhe ne të gjitha grupet Kuvendare që jemi kundër një çështje të tillë të bëjmë një rezolutë, e cila e obligon ministrin që ta shfuqizojë udhëzimin administrativ dhe ta shkëpusë kontratën që tani.

Memli Krasniqi, iu drejtua ambasadores, duke i thënë që nuk kishte asgjë personale me të dhe ekipin e saj, ne jetojmë në vazhdimisht këtu në Kosovë, ndërsa ju e keni një mandat, pastaj ne i mbajmë në mend edhe mandatet e kaluara me vendimet dhe politikat e kaluara dhe akoma një pjesë e tyre janë në fuqi, por kjo është një çështje tjetër, ju falënderojmë që e keni ngritur këtë problem, ky problem qenka ngritur nga viti i kaluar ndërsa ne e kemi ngritur moti, z. Konjufca tha që e kemi ngritur në 2010-tën, pra është duke u përmendur por askush nuk merr nismë, që të shkojmë tutje. Tani, unë kisha kërkuar mundësisht në mënyrë konkrete prej administratës se komisionit që të na bëjë një informacion përmbledhës se ku është situata, sepse unë nuk kam pasur informacion më herët dhe sot mora vesh që nëse nuk ndërrohet Udhëzimi Administrativ

në korrik, kontrata do të vazhdohet automatikisht edhe për 10 vite, përderisa herën e kaluar kur kemi diskutuar këtu, është thënë që kontrata i është vazhduar pa limit. Pastaj në si komision është mirë që të vendosim ta thërrasim ministrin në takim për këtë temë specifike dhe të ia bëjmë të qartë qëndrimet tona, sa i përket kësaj çështjeje.

Kryetarja –Ne, si deputet si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, kemi shumë mundësi të bëjmë punë të mira të cilat shkojnë edhe në zhvillimin ekonomik, edhe në të mirën e qytetarëve të Kosovës. Nuk kisha pasur dëshirë që ky takim të shndërrohet në debat politik me akuza dhe kundër akuza. Dua të ua përkujtoj kolegëve të mi deputet që nuk është vetëm ky udhëzim Administrativ që është në kundërshtim me ligjin, ne kemi edhe ligje tjera që janë nxjerrë udhëzime administrative që janë në kundërshtim me ligjin dhe udhëzime tjera në legjislacion sekondar që nuk është në dorën e deputetëve të Kuvendit, por në dorën tonë është që të monitorojmë se a po zbatohen në harmoni me bazën kryesore të ligjit apo jo, siç janë edhe udhëzimet administrative. Dua ta përmend një çështje se jemi po këta deputet që një vit sillet në seanca të Kuvendit, Ligji për miniera dhe minerale, e i cili nuk votohet po nga këta deputet, ligji ka dispozitat që parashihen që të zhblokohet sektori minerar dhe ka të bëjë me udhëzime administrative që po e ngulfasin sektorin, kështu që nuk është mirë të bëjmë politikë por t'i përvishemi punës që të bëjmë gjëra të mira për qytetarët e Kosovës. Njëkohësisht Ju njoftoj proceduralisht se ne s'kemi të drejtë ti rekomandojmë ministrisë por këtë e bënë vetëm Kuvendi, ndërsa, ne si komision mund ti dërgojmë letër ama jo direkt sepse rekomandimet tona shkojnë vetëm përmes Kuvendit.

Dardan Sejdiu –Unë po e shoh që ne këtu kemi kuorum, dhe pasi që kemi kuorum, e dëgjova me vëmendje znj.Bajrami, z.Zharku dhe z. Prestreshi kur ishte në raportim në komision, për mua është e qartë që kemi një ligj dhe kemi një Udhëzim Administrativ që është në kundërshtim me ligjin dhe kemi një kontratë e cila skadon, këtu kemi afat kohorë të kufizuar me një urgjencë të jashtëzakonshme me një temë që po na shkakton telashe. propozimi im është që komisioni ynë t'i dërgoj letër zyrtare ministrit dhe kryeministrit që këtë Udhëzim Administrativ ta amandamentojë, duke e pasur parasysh vërejtjet që u shpërfaqën këtu dhe për këtë kërkoj votën, pasi që është mbledhje e komisionit,

Muharrem Nitaj –Jam dakord me atë që tha kolegu z.Sejdiu, se si mund të dalim prej situatës. Këtu po thuhet që e keni ngritur që nga viti 2010, por po del që nuk keni arritur asgjë. Kontrata po duket që ka qenë asisojë e përpiluar që ka pamundësuar revokimin e saj, unë propozoj që mos ta kërkojmë këtë që e propozoj z. Sejdiu, por që të thërrasim në ditën e marte në komision ministrin, të kërkojmë të gjitha informacionet dhe të marrim të gjitha informacionet edhe nga zyra e Ambasadores edhe raportët tjera, pastaj ditën e martë të dalim me propozime konkrete apo votimin e një kërkesë që do të kërkonim amandamentimin e Udhëzimit Administrativ

Salih Zyba –Sa i përket propozimeve, unë mirëpres propozimin e z. Sejdiu, por nuk është i mjaftueshëm, propozimi që është për kryeministrin, do duhet të vinte materiali për deputetët, sepse nuk mund të zëvendësohet seanca me debat. Në këtë rast, për interpelancën, propozimi im është që t'i shkruajmë Qeverisë për material shtesë për të dhënat e plotësuar, sepse këtu ka kolegë që nuk i kanë informacionet e duhura që kalon afati dhe e mbron me fanatizëm procedurën deklarohen kundër monopolit por nuk i dine elementet të cilat garantohet monopoli, por i japin me automatizëm garanci monopolit. Pra ministri me automatizëm duhet të vijë në

seancë, sepse jemi duke folur për më pak se një muaj kohë dhe pas kësaj kohë me automatizëm do të kemi monopol nëse nuk shfuqizohet udhëzimi administrativ.

Dardan Sejdiu –Mendoj që një interpelancë do ishte e mirë, mirëpo duke e pasur parasysh kohën, unë jam i gatshëm të marrë mbi vetëkritikën për letrën të cilën e dërgojmë, sesa të humbim afatin kohorë dhe të vazhdohet me automatizëm kontratën, prandaj dua që të hedhet në votim propozimi im.

Memli Krasniqi – Propozoj që të fuzionohet propozimi im, i Dardanit dhe të tjerëve, që një letër ta dërgojmë duke kërkuar sqarime, informata, materiale shtesë dhe kërkesën për ndryshim ministrit z.Lekaj dhe ta ftojme sa më herët po në atë letër, që të vijë në mbledhjen e radhës në komision.

Dardan Sejdiu –Letra e cila do t'i dërgohet nga komisioni, ministrit dhe kryeministrit të Kosovës të jetë specifike me kërkesën që neni i cili e bën ripërtëritjen automatike të kontratës, të hiqet edhe ky udhëzim administrativ të amandamentohet, pastaj mund të vijë në mbledhje të komisionit dhe të raportojë.

Hykmete Bajrami –Nuk është çështja tek një nën të Udhëzimit Administrativ, por përmbajtjen e udhëzimit e diskutojmë kur të drafotjmë letrën, është komplet udhëzimi në disa nene që mundëson atë, pra i kundërligjshëm, sepse të gjitha kriteret për marrjen e licencës për homologim i përshtaten një kompanie të caktuar, problemi i vazhdimit me automatizëm është në kontratën aktuale të homologimit. Ne duhet të kërkojmë pezullim ose shfuqizim të Udhëzimit Administrativ dhe qeveria duhet të shkëpus kontratën me operatorin ekonomik, ne kur e dërgojmë këtë letër nëse ministri ka argumente kundër ai vjen dhe raporton, por nëse nuk ka ai s'ka nevojë të raportoj por vetëm e aprovon kërkesën tonë.

Kryetarja hodhi në votim propozimin e z.Memli Krasniqi. Për propozimin votuan tre deputetë, ndërsa katër deputetë votuan kundër, andaj propozimi nuk u miratua.

Glauk Konjufca –Letra e cila mendojmë të ia dërgojmë ministrit duhet të përmbaj disa elemente, elementi i parë është ajo çka folëm këtu, pra jemi takuar si komision së bashku me përfaqësuesit e BE-së, e dyta ky proces lidhet edhe me marrëveshjen e MSA-së, e treta Agjencia që është kompetente, në këtë rast Autoriteti Kosovar i konkurrencës ka dhënë udhëzime të sakta që është kundër konkurrencës, të gjithë jemi të një lloji pajtueshmërie që ky udhëzim duhet të pezullohet dhe që për të gjitha këto shqetësime të listuara, ministrin e thërrasim të paraqitet përpara komisionit që të diskutojmë këto problematika, por jo të kërkojmë informacione, sepse ne krejt e dimë se çfarë është duke ndodhur këtu.

Nataliya Apostolova, shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuese e Posaçme e BE-së në Kosovë –Ekziston një udhëzim administrativ dhe brenda këtij udhëzimi duhet të shmanget automatizmi i vazhdimit të kontratës dhe ky udhëzim duhet të amandamentohet nga ministri dhe ta bëjë në konformitet, në përputhje me rregullat e konkurrencës, por mënyra më e lehtë është që të shfuqizohet udhëzimi, para datës së korrikut, sepse pastaj do të duhet të shkoni në arbitrazh dhe ky është rreziku më i madh për ju.

Kryetarja hodhi në votim propozimin e z. Glauk Konjufca dhe propozimi u miratua njëzëri.

Mbledhja përfundoi në orën 17:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA